



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.03.2019, ora 9:30

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i vendimeve nr. 86, 87 dhe 88 datë 19.3.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në qarqet, Tiranë, Fier dhe Vlorë për plotësimin e vakancave të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë si dhe verifikimi i mandatit të deputetëve z. Ralf Gjoni, Nimet Musaj dhe znj. Enada Kapllani.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Ermonela Felaj, Musa Ulqini, Ulsi Manja.

Mungon:

Damian Gjikhuri

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e sotme të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Kuvendi i Shqipërisë, në vijim të vakancave të krijuara, si pasojë e heqjes dorë nga mandati i deputetit, në mbështetje të ligjit nr. 10.019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë depozituar në Kuvend vendimet nr. 86, 87 dhe 88 datë 19.03.2019.

Në mbështetje të nenit 13 të Rregullores, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin mblidhet për të bërë verifikimin e mandatit të deputetit që zgjidhet gjatë legjislaturës. Kanë fituar mandatin e deputetit, konkretisht:

- z. Ralf Gjoni nga lista shumemërore e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Tiranë.

- z. Nimet Musaj nga lista shumemërore e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Fier.

- znj. Enada Kapllani nga lista shumemërore e partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Vlorë.

Vendimet e Komisionit Qendror dhe draftaportin i keni të gjithë përpara.

A ka ndonjë mendim, ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim nga anëtarët e Këshillit, në lidhje me mandatin e deputetëve të ri?

Nuk ka.

Atëherë, jemi dakord!

Anëtarët e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin janë dakord me vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Atëherë, raporti i Këshillit do t'i kalojë seancës plenare për miratim!

Relatorja Znj. Klotilda Bushka do të lexojë raportin e përmbledhur.

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA